

**Akt Themelimi  
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar  
“ADORE”Sh.p.k**

**Aida Vojka**, atësia Pëllumb, lindur në Krujë, me 22/02/1986 me banim në Tiranë, me adresë: 1045 Sauk Rr. Hamdi Sina, Nd 50, shk. 1, ap. 2., me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr. 030260715 dhe me nr. personal I65222080M.

**Entela Shehu**, atësia Pjetër, lindur në Fushë-Arrëz, Pukë, me 03/06/1988 me banim ne Lushnje, me adresë rr. "Ismail Qemali" nr. 49., KP 9001, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me letërnjoftim nr. 032217258 dhe me nr. personal I85603083B.

Ne, të sipërshënuarat, si themeluese te kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, në të cilën jemi ortake, vendosëm të hartojmë këtë Akt Themelimi, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**Neni 1**

Sot, më datë 23/10/2018, ne themelueset krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të quajtur “ADORE” sh.p.k. Kjo shoqëri do të jetë me përgjegjësi të kufizuar për aq kohë sa nuk do të merret një vendim për shndërrimin e saj në një formë tjetër shoqërie të parashikuar nga legjislacioni për shoqëritet tregtare.

**Neni 2**

**Emri**

Emri i plotë i shoqërisë është “ADORE”sh.p.k.

**Neni 3**

**Zyra Qendrore**

Zyra Qendrore e shoqërisë do të jetë në Tiranë, në adresë: 1045 Sauk Rr. Hamdi Sina, Nd 50, shk. 1, ap. 2.

Me vendim të Asamblesë së Ortakeve, zyra e shoqërisë mund të ndryshohet, të hapen filiale dhe zyra përfaqësimi të saj brenda dhe jashtë Shqipërisë.

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është e papërcaktuar, dhe do të fillojë nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përashtim të rastit kur mbaron sipas parashikimeve të ligjit ose kur vendoset me vendim te Asamblesë se Ortakeve.

**Neni 5**  
**Objekti i Veprimitarisë**

Shoqeria tregtare "ADORE" Sh.p.k. ka si objekt veprimitarie:

1. Ndërmjetësim në fushën e pasurive të paluajtshme, vlerësimin e pasurive të paluajtshme, studime tregu per pasuri te paluajtshme, shitje dhe qiradhënie të pasurive të paluajtshme;
2. Cdo shërbim dhe aktivitet tjeter në lidhje me tregun imobiliar në të gjithe nivelet e shërbimit;
3. Administrimi i bashkëpronësise, mirëmbajtje dhe punime të ndryshme për restaurim dhe rikonstruktion të objekteve të ndryshme;
4. Konsulencë në fushën e ndërtimit përfshirë planifikim, projektim dhe mbikëqyrjen e zbatimit te punimeve;
5. Konsulencë në zhvillimin e pasurive të paluajtshme;
6. Komisioner dhe agjensi për të tretët.

**Neni 6**  
**Kapitali Themeltar**

Kapitali i shoqërisë do të jetë 100 (njëqind) Lekë, i zotëruar si më poshtë:

Nr.	Emri, Mbiemri	% që zotëron	Kuotat që zotëron
1	Aida Vojka	50 %	1 kuote
2	Entela Shehu	50 %	1 kuote

Ky kapital është i ndarë në 2 (dy) kuota. Secila prej kuotave ka vlerë 50 (pesëdhjetë) Lekë.

Kapitali themeltar do të depozitohet në një Bankë në Shqipëri, me një llogari të hapur në emër të shoqërisë në formim e sipër.

**Neni 7  
Administratori**

Administratore e shoqërisë do të jetë **Znj. Aida Vojka**. Kohëzgjatja e mandatit është 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

**Neni 8  
Dispozita e fundit**

Ky akt themelimi është hartuar në 4(katër) kopje, në gjuhën shqipe, me fuqi të njëjtë ligjore.

**THEMELUESET**

**Aida Vojka**  


**Entela Shehu**  
